



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA BORBU PROTIV KORRUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI - CORRUPTION AGENCY



RAPORT MBI PUNËN E AGJENCIONIT
PËR
GJASHTË MUAJT E PARË TË VITIT
2008

(1 janar – 30 qershor)

Tabela e përmbajtjes

I.	HYRJE	3
II.	DEPARTAMENTI PËR STRATEGJINË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE HETIMET ADMINISTRATIVE	3
i.	Aktivitetet në fushën e hetimeve	4
ii.	Aktivitetet në fushën e plotësimit dhe harmonizimit të legjislacionit.....	8
iii.	Aktivitetet në fushën e edukimit të publikut.....	9
III.	DEPARTAMENTI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT	9
i.	Mbikëqyrja e pasurive.....	9
ii.	Parandalimi i konflikti të interesit.....	12
iii.	Pranimi i Dhuratave	13
IV.	DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE	13
i.	Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme	13
ii.	Divizioni për Burime Njerëzore dhe Përkthimit	14
V.	ZYRA E PROKURIMIT	16
VI.	ZYRA PËR MARRËDHENIE ME PUBLIKUN.....	17
i.	Takime me gazetarë dhe qytetarë.....	17
ii.	Deklaratat për shtyp	17
iii.	Monitorimi i mediave gjatë periudhës janar - qershor 2008.....	17
iv.	Aktivitete dhe bashkëpunimi	19
VII.	PROBLEMET E NDESHURA	20
VIII.	PLANET DHE SFIDAT PËR GJASHTË MUJORIN E DYTË TË VITIT 2008.....	21
IX.	PËRFUNDIME.....	22

I. HYRJE

Ky raport pasqyron punën gjashtë mujore të AKK-së të kryer gjatë periudhës 1 janar- 30 qershor 2008. Në këtë raport janë përfshirë aktivitetet e kryera dhe të ndërmarra nga AKK-ja gjatë kësaj periudhe, të cilat janë paraqitur sipas fushave që mbulon secili departament.

Ky është raporti i katërt që Agjencioni paraqet përpara Këshillit. Përmes këtij raporti, Agjencioni synon paraqesë një pamje të qartë të iniciativave, aktiviteve dhe punës së përditshme të ndërmarra sikundër dhe problemeve e pengesave që Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit ka hasur në gjashtë muajt e parë të vitit 2008. Aprovimi dhe alokimi i buxhetit për vitin 2008 sipas kërkesës të paraqitur në qeveri si dhe aprovimi i organigramit sipas planit, ishin dy shtylla të forta për të startuar mbarë vitin 2008.

Gjatë këtij gjashtë mujori Agjencioni pati sfida të shumta, megjithatë rrugëtoi fuqishëm me mision dhe vizion të qartë. Me veprime të pandikuara nga presioni i jashtëm dhe me staf me integritet të lartë, rezultatet e arritura deritanimë tregojnë një rritje të dallueshme dhe eficientë e profesionalizëm që përmirësohet nga dita në ditë.

Aktivitetet e AKK-së kanë qenë të orientuara në këto drejtime:

- Zbatimi i ligjit;
- Parandalimi; dhe
- Edukimi.

Bazuar në tre shtyllat e lartpërmendura më poshtë do të shtjellohen iniciativat dhe aktivitetet e ndërmarra nga strukturat e Agjencionit.

II. DEPARTAMENTI PËR STRATEGJINË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE HETIMET ADMINISTRATIVE

Departamenti gjatë periudhës së 6 mujorit të parë të vitit 2008 ka zhvilluar një aktivitet tejet të ngjeshur në drejtim të përmbushjes së mandatit ligjor të përcaktuar në Ligjin kundër Korrupsionit, Rregullave Procedurale të Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit, Vendimit për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të AKK-së dhe me aktet e tjera të brendshme të aprovuara nga Drejtori i AKK-së, po ashtu janë zhvilluar aktivitetet tjera në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale brenda divizioneve të Departamentit me qëllim të forcimit të funksionalizmit të Agjencionit.

Me qëllim të arritjes të objektivave të lartpërmendura, Departamenti për periudhën raportuese e ka përqendruar aktivitetin jo vetëm në fushat për të cilat është përgjegjës por dhe në ato fusha të cilat janë vlerësuar si fusha me prioritet nga ana e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit. Përkatësisht aktiviteti është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- i) Hetimet;
- ii) Plotësimi dhe harmonizimi i legjislacionit; dhe
- iii) Edukimi i publikut.

i. Aktivitetet në fushën e hetimeve

Në kuadër të zbatimit të kornizës ligjore, Departamenti ka kryer aktivitetet e tij në lidhje me pranimin e rasteve të dyshuara për veprime korruptive, zhvillimin e procedurës së hetimeve, kompletimin e raporteve për hetimet e përfunduara, përcjelljen e informatave në prokuroritë kompetente dhe autoritetet policore, etj. Si më poshtë vijon paraqitet në mënyrë narrative, tabelare dhe statistikore të dhënat e aktiviteteve në fushën e hetimeve.

Rastet e pranuar në periudhën Janar – Qershor 2008

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit ka pranuar raste të dyshuara për veprime korruptive, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007 numri i rasteve të paraqitura nga qytetaret është 6 raste më i vogël, ndërsa sa i përket gjendjes së korrupsionit në Kosovë dhe shtrirjen e tij në institucionet e Kosovës, në bazë të rasteve të paraqitura pranë Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit kemi situatën si në vijim:

- Departamenti i Hetimeve sa i përket rasteve të paraqitura për vitin 2008, që përfshin periudhën kohore prej 1 janar deri më 30 Qershor 2008 nga qytetaret dhe subjekte tjera ka pranuar gjithsejtë 68 raste të dyshimit për veprime korruptive në institucionet publike të Kosovës, të cilat, janë kategorizuar varësisht prej asaj së ndaj cilit institucion janë paraqitur rastet.
- Njëjtë sikurse edhe gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2007, rastet e pranuar nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit, dominohen nga numri i rasteve të paraqitura kundër personave zyrtarë të **institucioneve të tjera**, ku në këtë kategori përfshihen: Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës, Hekurudhat e UNMIK-ut, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Për këtë kategori janë paraqitur 25 raste që shprehur në përqindje nga totali i rasteve përbën 36% të rasteve.
- **Qeveria e Kosovës**, përkatësisht zyrtarët publik të saj pasojnë me numrin më të madh të rasteve të paraqitura për veprime korruptive të dyshuara, ndërkaq për këtë kategori janë paraqitur 16 raste, shprehur në përqindje janë 24% të rasteve.
- **Gjykatat**, ku përfshihen të gjitha shkallët e gjykatave, nga ana e personave fizik dhe atyre juridik janë paraqitur 16 raste të dyshuara për veprime korruptive, shprehur në përqindje shifrat e përmendura janë 24% nga totali i rasteve.
- **Pushteti lokal**, përkatësisht personat zyrtarë të kuvendeve komunale, Departamenti ka pranuar 9 raste të dyshuara për veprime korruptive apo një shifër e tillë e shprehur në përqindje është 13% të rasteve .
- **Prokuroria**, përfshirë këtu dhe ato prokurori të nivelit komunal dhe të qarkut krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007 kur ky institucion në përqindjen totale paraqiste vetëm 1% të rasteve, gjatë kësaj periudhe janë paraqitur 2 raste apo shprehur në përqindje 3% të rasteve.




Fig.1. Pasqyrë e rasteve të paraqitura në Agjension në periudhën 1 janar – 30 qershor 2008

Rastet e proceduara në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore

Agjensioni nga viti 2007 ka bartur 16 raste të paraqitura për veprime korruptive të dyshuara, ku në lidhje me këto Departamenti ka zhvilluar procedurën e hetimeve konform ligjit në fuqi dhe nga këto raste 9 raste janë proceduar në prokuroritë publike kompetente, ndërsa pas procedurës së hetimeve të zhvilluar dhe jo për shkak të kompetencës së Agjensionit për rastet në fjalë apo për shkak të mungesës së fakteve të paraqitura, prokuroritë kanë mbyllur 7 raste të bartura nga gjashtë mujori i dytë i vitit 2007.

Të gjitha rastet e paraqitura për veprime korruptive të dyshuara për të cilat është konstatuar se ka prova të mjaftueshme dhe se Agjensioni është kompetent, **gjatë gjashtë mujorit të parë për vitin 2008 janë proceduar 21 raste të dyshuara për veprime korruptive**, pas shqyrtimit paraprak dhe hetimeve të zhvilluara konform legjislacionit në fuqi, rastet janë proceduar në Prokuroritë Publike kompetente apo në organet policore.

Ndërsa pjesa i përket aspektit të trajtimit me prioritet të rasteve të dorëzuara nga Agjensioni gjatë këtij viti, për shkak të rëndësisë së disa rasteve të hetuara të cilat i janë përcjellë Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës, Agjensioni ka pasur një bashkëpunim të shkëlqyeshëm.

Rastet e dërguara në Prokurori për procedim të mëtejshëm penal në numrin më të madh janë ato të paraqitura kundër Qeverisë së Kosovës, ku gjatë periudhës raportuese janë përcjellë 8 raste të dyshuara për veprime korruptive, shprehur në përqindje kjo shifër është 38% të raste.

Ndaj personave zyrtarë të gjykatave janë dorëzuar në prokurorinë kompetente për procedim të mëtejshëm 6 raste, shprehur në përqindje kjo është 29%.

Pjesa i përket pushtetit lokal, Agjensioni ka pranuar një numër të konsiderueshëm të rasteve të dyshuara për korrupsion, ndërsa janë dorëzuar në Prokurori për procedim të mëtejshëm 4 raste të dyshuar për veprime korruptive, pjesëmarrja e këtyre institucioneve në totalin e rasteve të paraqitura është 19 %.

Në lidhje me institucionet e tjera ku përfshihen: Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës, Hekurudhat e UNMIK-ut,

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit; për periudhën raportuese janë dorëzuar në Prokurorinë kompetente 3 raste, shprehur në përqindje kjo është 14 % e numrit të përgjithshëm e rasteve të proceduara.

Është e rëndësishme të thuhet së rastet të cilat janë paraqitur kundër Prokurorisë Publike sikurse edhe rastet tjera janë duke u trajtuar, përkatësisht është duke u zhvilluar procedurë hetimore dhe në kohën e përfundimit të procedurës se tille do të kemi vendimin në lidhje me këto raste. Ndërsa përsa i përket Kuvendit të Kosovës, Agjensioni nuk ka pasur asnjë rast të pranuar për veprime korruptive.




Fig.2. Pasqyrë e rasteve të proceduara në prokuroritë publike kompetente janar – korrik 2008

Së fundi sa i përket rasteve të mbyllura gjatë periudhës raportuese, Agjensioni pasi ka kryer hetimet nuk ka gjetur prova me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet e paraqitësve të rasteve për veprime korruptive të zyrtarëve të institucioneve publike përkatëse, po ashtu disa nga këto raste janë në procedurë në prokuroritë publike kompetente, ku në lidhje me këtë janë marrë konfirmimet nga prokuroria dhe për këtë periudhë janë mbyllur 13 raste të tilla.

Pasqyra e përgjithshme e rasteve të paraqitura në AKK

Institucioni	Raste e paraqitura	Rastet e mbyllura nga AKK	Rastet e dërguara në Prokurori	Rastet në procedurë
Ndërmarrjet publike	25	2	03	20
Qeveria	16	5	08	3
Gjykatat	16	4	06	6
Pushteti lokal	09	3	04	2
Prokuroritë	02	-	-	2
Gjithsej	68	14	21	33

Tabela A: Pasqyrë e përgjithshme e rasteve të paraqitura dhe të proceduara në AKK gjatë periudhës janar-qershor 2008

Natyra e rasteve të proceduara

Në përputhje më legjislacionin në fuqi, përkatësisht Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, natyra e rasteve të dorëzuara në prokuroritë publike kompetente dhe organet policore sipas veprave penale është si në vazhdim:

- *Shpërdorim i detyrës zyrtare* – janë proceduar tek organet kompetente 5 raste;
- *Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare* – janë proceduar 4 raste;
- *Marrja e ryshfetit* - janë proceduar 4 raste të dyshuara;
- *Ushtrim i ndikimit* – janë proceduar 2 raste të dyshuara për veprime korruptive;
- *Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore* – janë proceduar 2 raste; dhe
- *Falsifikim i dokumentacionit zyrtar* – janë proceduar 4 raste të dyshuara.

Gjatë gjithë vitit 2007, në prokurori janë përcjellë 47 informata, vec gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2008, janë përcjellë 21 informata. Deritanimë kemi 23 informata kthyesë nga Prokuroritë. Nga to në 12 raste janë marrë veprime konkrete dhe në 11 raste informatat tona janë hedhur si të papaba (10 nga këto raste i përkasin gjyqësorit dhe kurse 1 rast i përket pushtetit lokal).

Qyteti/ Institucionet	Lëndët e përcjella	Arrestime	Hetime	Aktakuza	Lëndë të hedhura	Pa informata kthyesë
Prishtinë	21	2	1	-	2(gjyq)	16
Pejë	5	-	1	2	2(gjyq)	-
Prizren	5	-	1	-	4 (gjyq)	-
Gjilan	2	-	-	-	1(P.L)	01
Mitrovicë	1	-	-	-	1(gjyq)	-
P. Speciale	19	-	4	-	1(gjyq)	14
SHPK	12	-	-	1	-	11
Policia e UNMIK- ut	2	-	-	-	-	02
FIU	1	-	-	-	-	01
Gjithsej	68 (47+21)	2	7	3	11	45

Tabela B: Pasqyra e informatave të dorëzuara në prokurori që nga funksionalizmi i AKK-së deri më 30 qershor 2008

Gjatë kryrjes së hetime, Departamenti ka hasur në pengesa përsa i përket marrjes së informacionit të kërkuar, e ka pasur shumë raste kur institucionet kanë refuzuar dorëzimin e dokumentacionit relevant për rastin që hetohet. Në veçanti, AKM-ja ka refuzuar të bashkëpunoj në dy raste që ishin nën hetim, kurse Ministria për Kthim në një rast.

Viti i kryerjes së veprimeve korruptive	Rastet e paraqitura pranë AKK-së
2003	8
2004	7
2005	15
2006	21
2007	14
2008	3
Gjithsej	68

Tabela C: Pasqyra e rasteve të përcjella në prokurori sipas viteve kur janë kryer veprimet korruptive

Pasoja e korrupsionit në shifra

Pasoja ekonomike të veprimeve korruptive janë të mëdha, kjo bazuar në një analizë të thjeshtë të rasteve të pranuar nga Agjensioni dhe pastaj të përcjella në prokuroritë kompetente si dhe autoritetet policore vendore dhe ndërkombëtare. Gjatë periudhës raportuese dëmi i cili konsiderohet se i është shkaktuar si Buxheti të Konsoliduar të Kosovës po ashtu edhe personave fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës 6.000.000 (milion) Euro.

ii. Aktivitetet në fushën e plotësimit dhe harmonizimit të legjislativës

Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor dhe funksionalizimit të plote të Agjencionit, Departamenti gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm në drejtim të përgatitjes së akteve të brendshme, ku në këtë aspekt janë përgatitur 11 Propozim – Vendime për nënshkrim nga ana e Drejtorit të AKK-së.

Gjithashtu, Departamenti ka marrë pjesë aktivisht në Grupin Punues të AKK-së në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër Korrupsionit, i cili tashmë është në procedurë shqyrtimi në Qeveri dhe më pas do të dërgohet për diskutim e aprovim në Kuvend.

Në vijim, Departamenti ka dhënë komentet në lidhje me harmonizimin e ligjeve bazike të punës së AKK-se me ligjet e pakos së Ahtisari, të cilat i janë dërguar grupit përkatës punues për shqyrtimin dhe inkorporimin e tyre.

Pjesëmarrja aktive në Grupin Punues të Agjencionit për hartimin e strategjisë së re kundër korrupsionit, ku Departamenti e vecanërisht Divizioni për Strategjinë kundër Korrupsionit, Edukimit dhe Trajnimit kanë dhënë ndihmesën e tyre në vlerësimin e strategjisë së kaluar e përpilimin e draft strukturës së strategjisë së re.

Pjesëmarrja dhe dhënia e asistencës profesionale në takimin e nëngrupit qeveritar për anti-korrupsion në kuadër të reformës së administratës publike në Kosovës të organizuar nga Ministria e Shërbime Publike.

Përgatitja dhe përpilimi i masave përkatëse për Planin e zbatimit të Dokumentit të Partneritetit Evropian nga Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit.

iii. Aktivitetet në fushën e edukimit të publikut

Me qëllim të sensibilizimit të opinionit të gjerë, qytetarëve dhe institucioneve publike si atyre të nivelit qendror edhe atij lokal, Agjensioni gjatë periudhës Mars – Prill 2008 me ndihmën dhe përkrahjen e UNDP dhe OSCE ka organizuar fushatën kundër korrupsionit. Në fushatën e rradhës më moto “Korrupsioni mbaron këtu dhe më ndihmën tuaj” institucionet të cilat janë përfshirë në zbatimin e kësaj fushate kanë qenë të gjithë ministritë në nivel qendror dhe 15 kuvende komunale në të gjithë Kosovën.

Zyrtarët e departamentit kanë qenë të kycur fuqishëm në organizimin e takimeve për të zbatuar fushatën por këto takime janë shfrytëzuar dhe si një mundësi e mirë për të pasur një mundësi më të afërt me nëpunësit civil, për të shpërndarë gjerësisht informacionin mbi misionin e Agjensionit e për të rritur besimin se Agjensioni do të ndodhet gjithmonë pranë tyre e se duhen rritur përpjekjet për bashkëpunimin e dyanshëm.

Ofrimi i këshillave ligjore për qytetarët

Departamenti ka ofruar edhe këshilla të konsiderueshme ligjore për qytetarë të ndryshëm të cilët i janë drejtuar Agjensionit për paraqitjen e ankesave të tyre. Gjithashtu, zyrtarët e Departamentit janë munduar që ti asistojnë si qytetarët e thjeshtë por edhe të gjitha kategoritë e tjera që paraqiten pranë Agjensionit me informacion të dhënë në mënyrë profesionale e të shpejtë si dhe për ti ndihmuar në paraqitjen e rasteve duke rritur besimin tek ta për seriozitetin në punën e kryer në Agjension. Në ato raste kur Agjensioni nuk ka qenë kompetent në trajtimin e rasteve të paraqitura i ka udhëzuar subjektet e ndryshme se tek cili institucion kompetent dhe si duhet ti adresojnë ankesave e tyre.

III. DEPARTAMENTI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2008, Departamenti i Parandalimit duke u bazuar në mandatin që i është dhënë me Ligjin kundër Korrupsionit (LKK), Rregullave të Brendshme Procedurale të Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit dhe Rregullave për Organizimin dhe Sistematizimin e Agjensionit, ka zhvilluar një aktivitet të larmishëm me qëllim të realizimit të obligimeve që dalin nga korniza ligjore dhe akteve tjera të theksuara më lart.

Detyrat kryesore të këtij departamenti janë të fokusuara në: mbikëqyrjen e pasurive të zyrtarëve të lartë publik; mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Për përmbushjen më të lehtë të obligimeve që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore, puna në Departament është e shpërndarë midis Divizionit për Mbikëqyrjen e Pasurive, Pranimit të Dhuratave dhe Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave.

i. Mbikëqyrja e pasurive

Duke u bazuar në nenin 39 të LKK-së, Agjensioni mbikëqyr pasurinë e personave zyrtar të lartë në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi zyrtar i lartë në një formular të posaçëm, i cili është përcaktuar nga Agjensioni. Sipas dispozitave ligjore të LKK-së, formularët e plotësuar duhet të dorëzohen pranë Agjensionit, deri më 31 mars, për vitin paraprak. Deri me këtë datë për

vitin 2008, këtij obligimi ligjor ju kanë përgjigjur 560 apo 74.9% e zyrtarëve të lartë publik nga 747 të tillë, që kanë qenë të obliguar për deklarim të pasurisë sipas LKK-së.

Në pajtim me nenin 43.1 të LKK-së, nëse zyrtari i lartë nuk dorëzon informacionin e referuar në nenin 41 dhe 42 të LKK-së, brenda afateve të përcaktuara në këtë Ligj, Agjensioni nxjerr një paralajmërim dhe vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e nxjerrjes së paralajmërimit.

Bazuar në këtë, Departamenti pas verifikimit të listave të zyrtarëve të cilët nuk kishin dorëzuar formularët, me datë 3 prill 2008, nxori një paralajmërim dhe vendosi një afat të ri për dorëzimin e formularëve. Afati i ri i vendosur nga AKK përcaktonte datën 25 prill 2008, si afati i fundit ligjor për dorëzimin e formuluarve të deklarimeve, ku numri i zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë deri me këtë datë arrinte në 695 apo 93.0 %, në ndërkohë ka vazhduar të vijë formularët edhe pas kësaj date.

Në rastet kur zyrtari i lartë nuk ka dorëzuar informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në ligj, Agjensioni ka informuar organin ku zyrtari i lartë ushtron detyrën e tij, dhe në pajtim me nenin 43.3 të LKK-së është kërkuar që paga ose shpërblymi i pagës të zvogëlohen me 1/5 për çdo muaj, derisa në Agjensionin Kosovar kundër Korrupsionit të merret njoftimi se zyrtari i lartë ka dorëzuar informacionin e kërkuar. Numri i zyrtarëve të lartë, ndaj të cilëve është kërkuar që të merret kjo masë ndëshkuese ka qenë 31. Lidhur me gjendjen e përgjithshme të procesit të deklarimeve të pasurisë, kemi Tabelën D, ku jepen në mënyrë të detajuar përqindjet e zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë, të ndarë në bazë të institucioneve.

Institucionet	Numri i zyrtarëve të lartë të obliguar	Pozitat e paplotësuar a	Numri i zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar	Numri i zyrtarëve të lartë që nuk kanë deklaruar	Përqindje e deklarimit
Kuvendi	123	-	120	3	97.5 %
Presidenca	3	-	3	0	100 %
Qeveria	226	-	222	4	98.2 %
Gjykatat	307	-	297	10	96.7 %
Prokuroria	88	-	87	1	98.8 %
Totali	747	-	729	18	97.5 %

Tabela D: Përqindjet e zyrtarëve që kanë deklaruar dhe nuk kanë deklaruar pasurinë të ndara sipas institucioneve përkatëse.

Me 31 korrik skadon afati për të deklaruar pasurinë pas të cilës datë konform nenit 43.4 të LKK-së, Agjensioni njofton organin përgjegjës për fillimin e procedurave të shkarkimit nga detyra. Nga Tabela D, shihet se në periudhën në vijim ka vazhduar pranimi i formularëve nga zyrtarët e lartë publik, që nuk e kanë përmbushur obligimin e tyre, në afatet e përcaktuara sipas LKK-së dhe se përqindja e deklarimit në total deri me 30 qershor 2008, është rritur në 97.5%.

Gjithashtu, në bazë të detyrimit ligjor që Agjensioni duhet t'ia paraqesë Këshillit të Agjensionit pasuritë e personave zyrtarë që punojnë në Agjension, pasi ai është organi i cili i mbikëqyr këtë të fundit, gjatë muajve maj-qershor, Departamenti ka përmbyllur edhe procesin e deklarimit nga

ana e të punësuarve në AKK, përkatësisht janë paraqitur deklaratimet e 21 zyrtarëve para Këshillit të Agjencionit.

Në kontekstin e mirëmenaxhimit të Departamentit në përgjithësi dhe divizioneve të tij në veçanti, gjatë kësaj periudhe për të cilin po raportojmë është duke vazhduar procesi i konsolidimit i bazës elektronike të të dhënave.

Kontrolli i Formularëve të Deklarimit të Pasurive

Gjatë muajit qershor zyrtarët e Departamentit të Parandalimit e kanë përfunduar edhe procesin për shqyrtimin dhe kontrollin e formularëve mbi deklaratimin e gjendjes së pasurisë, në kuptim të përmbushjes së rregullt të formularit, të plotësimit adekuat dhe në bazë të kërkesave që dalin nga formulari.

Pas kontrollit teknik/logjik të formularëve, në 280 apo 37.4 % të formularëve ka mungesa në mënyrën e të plotësuarit. Në 216 apo 28.9 % të rasteve nuk janë deklaruar të hyrat vjetore. Në 55 apo 7.3 % e rasteve nuk është deklaruar informacioni i nevojshëm rreth pasurisë së paluajtshme, ndërsa në 52 apo 6.9 % të rasteve ka mungesë informacioni rreth parave të gatshme, pasurisë së luajtshme dhe të dhënave të tjera ku përfshihen numri personal i deklaruesit të pasurisë, përbërja familjare etj. Tabela 2 ofron të dhëna në formë grafike lidhur me aspektet e lartpërmendura.




Fig 3: Të dhënat grafike mbi shqyrtimin dhe kontrollin e formularëve të deklaratimit të pasurisë

Në krahasim me vitin 2007, pas kontrollit teknik-logjik të këtij viti, kemi vërejtur rënie të plotësimit jo adekuat të formularëve, dhe atë për 12.4 %. Në këtë rënie të plotësimit jo adekuat të formularëve nga ana e zyrtarëve të lartë, kanë ndikuar ndryshimi dhe plotësimi i formularit mbi deklaratimin e pasurisë dhe caktimi i pikave kontaktuese nëpër institucione, ku janë mbajtur trajnime dhe kontakte me të gjitha pikat kontaktuese lidhur me ndihmën që mund të ju japin zyrtarëve të lartë në plotësimin e formularëve.

Vlen të theksohet së departamenti i ka ndërmarrë të gjitha hapat e duhur në rritjen e bashkëpunimit me institucionet që kanë mision të përafërt me Agjensionin në fushën e luftimit të korrupsionit, ku kemi 3 raste që kemi shkëmbyer informacione të kërkuara nga institucionet e lartë cekura.

ii. Parandalimi i konfliktit të interesit

Bazuar në përgjegjësitë e dhëna nga Ligji kundër Korrupsionit, Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka ndërmarrë veprime të caktuara në pajtim me dispozitat ligjore për mbikëqyrjen e konfliktit të interesit dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit. Shqyrtimi i formularëve mbi gjendjen e pasurisë është i vazhdueshëm për verifikimin e gjendjes së konfliktit të interesit tek zyrtarët e lartë publik.

Përveç shqyrtimit të formularëve të zyrtarëve të lartë, deri tani, Agjensionin ka pranuar informata të bazuara për ekzistencën e konfliktit të interesit për 9 zyrtarë të lartë publik të institucioneve të Kosovës si dhe ka vepruar konform dispozitave ligjore të LKK-së, ku me anë të ndërhyrjes së Agjencionit, është arritur shmangia nga gjendja e konfliktit të interesit.

Institucionet	Rastet e konfliktit të interesit	Arritja e shmangies së konfliktit të interesit	Raste ende në shqyrtim	Raste të mbyllura
Qeveria	8	6	2	0
Institucionet e tjera	1	-	-	1
Totali	9	6	2	1

Tabela E: Të dhënat për rastet e konfliktit të interesit në institucionet publike gjatë periudhës janar-qershor 2008

Në fushën e parandalimit të korrupsionit, Departamenti ka vepruar në parandalimin e keqpërdorimeve të procedurave të tenderimit dhe shmangien e konfliktit të interesave në institucionet e Kosovës, duke dhënë opinione dhe sqarime në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave, dhuratave dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me përmbajtjen e LKK-së.

Në pajtim me kornizën ligjore dhe me qëllim të eliminimit dhe parandalimit të shkaqeve të korrupsionit, Departamenti ka vepruar në ato raste ku janë vërejtur shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik nëpër institucionet e Republikës së Kosovës. Veprimet janë ndërmarrë kryesisht në ato raste ku janë vërejtur favorizime apo diskriminime të operatorëve ekonomik, njëkohësisht edhe në ato raste ku janë vërejtur marrëveshjet e fshehta, qoftë në mes operatorëve ekonomik apo mes operative ekonomik dhe autoritetit kontraktues. Vlera e paralogaritur e tenderëve të anuluar arrin shifrën mbi 3.000.000 (tre milion) Euro.

Institucionet	Raste të paraqitura	Raste për Dep. hetimeve	Raste për shqyrtim	Raste të parandaluara	Vlera e parandaluar
Qeveria	6	4	-	2	2.500.000
Pushteti Lokal	1	-	1	-	100.000
Të tjera	1	-	-	1	500.000
SHPK	1	-	1	-	-
Totali	9	4	2	3	3.100.000

Tabela F: Të dhënat mbi abuzimet e shkeljet në proceset e prokurimeve publike

Po ashtu, kemi trajtuar disa lëndë, të cilat gjatë shqyrtimit është vërejtur dyshimi për vepra të korrupsionit dhe mundësia e parandalimit të kësaj dukurie ishte e pamundur, në këto raste Departamenti ia ka dërguar lëndët Departamentit të Hetimeve për hetime të mëtutjeshme.

iii. Pranimi i Dhuratave

Në pajtim me kreun e IV të LKK-së, që ka të bëjë me pranimin e dhuratave, gjatë këtij gjashtë mujori, Departamenti ka marrë masa konkrete, fillimisht ka përgatitur katalogun e veçantë për dhuratat, ka përgatitur udhëzimet për plotësimin e këtij katalogu si dhe ka caktuar pikat kontaktuese nëpër institucione për koordinimin e veprimeve që dalin nga LKK-ja, përkitazi me dhuratat.

Në kuadër të kësaj iniciative, sipas nenit 35 të LKK-së të gjitha institucionet që janë të detyruara me ligj të mbajnë katalogët e dhuratave i dërgojnë kopjet e katalogëve për vitin paraprak në Agjension jo më vonë se dita e fundit e marsit të vitit vijues për vitin paraprak. Sipas afatit ligjor 3 (trë) nga 18 (tetëmbëdhjetë) institucione kanë sjellë katalogët e dhuratave, ndërsa të tjerët, kanë njoftuar me shkrim se zyrtarët e tyre nuk kanë pranuar asnjë dhuratë gjatë vitit paraprak.

IV. DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Për periudhën raportuese Departamenti i Administratës paraqet punën e kryer nga divizionet e mëposhtme :

- Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme; dhe
- Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Përkthimit.

i. Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme

Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme ka kryer punë të rregullta administrative si :

- shërbimet teknike në automjete, gjenerator, pajisje dhe në mirëmbajtjen e objektit;
- përgatitjen dhe pagesat e të gjitha shpenzimeve të AKK-së;
- dorëzimin e të gjitha shkresave zyrtare në Republikën e Kosovës dhe punë tjera

Më poshtë paraqitet buxheti i lejuar nga Kuvendi i Kosovës për AKK-në për vitin 2008.

Kategoritë ekonomike	Shumat
Pagat dhe mëditjet	147,151.00 €
Mallra dhe shërbime	284,649.00 €
Shpenzimet komunale	24,800.00 €
Gjithsej	456.600.00 €

Nr	Përshkrimi	Alokimi	Shpenzimet	Zotuar	Shpenzimet + Zotuara (3+4)	% e shpenzimeve 3/2	% e shpenzimeve dhe zotimeve 5/2
1	Pagat dhe mëditjet	66418.80	38717.15	0.00	38717.15	58.29	58.29
2	Mallra dhe shërbime	157675.00	80340.63	18549.05	98889.68	50.95	62.72
4	Shpenzimet komunale	11883.00	3760.40	0.00	3760.40	31.65	31.65
	GJITHSEJ	235976.80	122818.18	18549.05	141367.23	52.05	59.91

Figura G: Tabela e shpenzime në kategoritë ekonomike gjatë gjashtë mujorit të parë të 2008-s.

Siç shihet, deri te mosrealizimi i buxhetit në kufijtë e planifikuar të rrjedhës së parasë në kategorinë ekonomike “paga dhe mëditje” ka ardhur për shkak të pranimit të punëtorëve të rinj pas lejimit në muajin e tretë e kur procesi i pranimit vazhdon ende .

Kurse në kategoritë tjera ekonomike kemi një realizim të shpenzimeve në rritje për arsye se stafi nuk është i plote ende dhe nevojat janë në rritje të vazhdueshme edhe pse përqindja është e vogël në krahasim me planifikimin e buxhetit.

ii. Divizioni për Burime Njerëzore dhe Përkthimit

Puna e kryer nga ky divizion është e bazuar në zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe procedurat e rekrutimit. Gjatë periudhës kohore janar-qershor janë bërë shpalljet e 9 (nëntë) konkurseve për pozitat si më poshtë:

1. Drejtor të Departamenti i Parandalimit;
2. Shef i Divizioni i Parandalimit të Konfliktit të Interesave;

3. Zyrtarë të Lartë për Mbikëqyrjen e Pasurisë dhe Dhuratave;
4. Zyrtarë të Lartë për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
5. Shef i Divizionit i Legjislacionit dhe Edukimit;
6. Zyrtarë të Lartë për Zbulim dhe Hetime;
7. Zyrtarë të Lartë për Legjislacion dhe Edukim;
8. Zyrtar i Lartë për Përkthime Shqip-Serbisht;
9. Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa; dhe
10. Shofer/ Korrier.

Të gjitha pozitat janë shpallur në gazetata ditore në të dy gjuhët shqip dhe serbisht ndërsa në radio vetëm në gjuhën serbe. Nga të gjitha këto pozita kemi pasur numër të dëshiruar të aplikantëve.

Vendimi për komisionet e selektimit dhe intervistimit janë bërë ashtu si parashihen në rregulloren 2001/36 pastaj komisioni me një përgjegjësi të plotë ka vazhduar punën e tyre.

Nga të gjithë këto pozita kemi të punësuar 10 (dhjetë) shërbyes, të gjithë të punësuarit janë pajisur me kontratë punë me 3 (tre) muaj punë provuese dhe mundësi vazhdimi për 3 (tre) vite si dhe vendimet, të gjithë janë futur në sistem të pagave nga MSHP-ja.

Në shkurt është bërë edhe vlerësimi i periudhës një vjeçare të punës për disa të zyrtarë të Agjencionit, vlerësim i cili iu ka mundësuar të vazhdojnë të jenë pjesë e stafit të Agjencionit.

Gjatë kësaj kohe kemi pasur edhe një numër trajnimesh si në vend dhe jashtë vendit për avancimin e zyrtarëve të Agjencionit dhe për të rritur profesionalizmin dhe efikasitetin në punë.

Me poshtë paraqitet në mënyrë tabelare trajnimet, aktivitetet, takimet apo konferencat në të cilat kanë marrë pjesë zyrtarët e Agjencionit gjatë periudhës raportuese.

Muaji	Titulli i trajnimit	Organizimi nga	Vendi
Janar 2008	Anti-korrupsioni	Hope Fellowhips	Prishtinë, Kosovë
	Menaxhimi strategjik i anti-korrupsionit	Hope Fellowhips	Prishtinë, Kosovë
Shkurt 2008	Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për rritjen e kapaciteteve investiguese në kontrollin e deklarimit të pasurive dhe në parandalimin e konfliktit të interesit	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	Tiranë, Shqipëri
	Harmonizimi i luftës kundër korrupsionit në Evropë	Dbb Akademie	Cologne, Gjermani
Mars 2008	Summiti i Përvitshëm për Mashtrimin dhe Korrupsionin, 2008	The International Leader in Audit & Information Security Training	Stokholm, Suedi
	Zhvillimi dhe implementimi i politikave publike	IKAP	Prishtinë, Kosovë
	Tryezën e rrumbullaket për diskutimin e ekspertizës së Këshillit	Këshilli i Evropës	Strasbourg, Francë

	të Evropës		
Prill 2008	Konferenca kundër Korrupsionit – Zbatimi i përpjekjeve Anti-korrupsion	International Bar Association	Paris, Francë
	Organizimi i punës	IKAP	Prishtinë, Kosovë
Maj 2008	Definicioni i Dobësive Institucionale dhe Forcimi i Kapaciteteve Parandaluese dhe Represive.	CIES-i; ANU-ja & OLAF-i	Lisbon, Portugali
	Organizimi i punës	IKAP	Prishtinë, Kosovë
	Forenziket e TI për hetuesit e Krimit Financiar	AER	Vushtri, Kosovë
	Vlerësimi i nevojave për trajnime	IKAP	Prishtinë, Kosovë
	Anti-pastrimi i parave dhe gjurmimi i pasurisë	AER	Vushtri, Kosovë
Qershor 2008	Fuqizimi i kapaciteteve Kosovare për luftimin e pastrimit të parave dhe korrupsionit	AER	Vushtri, Kosovë

V. ZYRA E PROKURIMIT

Aktiviteti i zyrës së Prokurimit për periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2008 ka qenë i orientuar rreth:

- Përgatitjes dhe shpalljes së 1 tenderi, 1 ri-tenderim, 6 kuotime çmimesh, 4 blerje minimale dhe 1 procedurë të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë;
- Anulimin e 1 tenderi, 1 kuotimi çmimesh, 1 procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë; si dhe
- Janë përgatitur lëndë për pagesë sipas kontratave afatgjate dhe dokumentacionit për pagesa të ndryshme që kanë arritur në Agjension.

Të shprehura financiarisht aktivitetet e sipërpërmendura paraqiten në këtë mënyrë:

Mënyra e blerjeve	Shuma (€)	Përqindja (%)
Blerje sipas metodës së tenderit	0.00 €	0.00 %
Blerje sipas metodës kuotim i çmimeve	19,466.40€	93.17%
Blerjet me vlerë minimale	1,426.97€	6.83%
Blerjet me procedura të negociuara pa publikim të njoftimit pas kontratës	0.00 €	0.00%
Nën-totali	20,893.37€	100%
Pagesat sipas kontratave afatgjate	43,539.41€	
Pagesat e ndryshme	7,865.04€	
TOTALI	72,297.82€	

VI. ZYRA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Zyra për Marrëdhënie me Publikun, punën e ka të përqendruar kryesisht në këto aspekte:

- Takime me gazetarë dhe qytetarë;
- Deklaratat për shtyp;
- Monitorimi i mediave për periudhën janar – qershor 2008; dhe
- Aktivitete dhe bashkëpunimi.

i. Takime me gazetarë dhe qytetarë

Gjatë gjithë periudhës raportuese ndaj Agjensionit ka pasur një interesim të madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve por edhe nga ana e publikut për sa i përket iniciativave dhe aktiviteteve të Agjensionit, ku nuk kanë munguar dhe interesimi për të bashkëpunuar ngushtësisht për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni në shoqërinë kosovare.

Gazetarë sikundër dhe qytetarë të thjeshtë gjatë këtyre 6 muajve kanë trokitur shpesh në derën e institucioneve me qëllim për të marrë informacione e të dhëna të detajuara se si mund ta ndihmojnë Agjensionin apo bashkëpunojnë me të. Zyrtarët e Agjensionit kanë qenë gjithmonë të gatshëm e iu kanë ofruar asistencë të specializuar dhe bashkëpunim në rastet kur ka pasur dyshime të bazuara për raste korruptive.

ii. Deklaratat për shtyp

Gjatë këtyre 6 muajve të parë të vitit 2008, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun ka luajtur një rol të rëndësishëm në bërjen publike dhe shpërndarjen në të gjithë median e shkruar dhe elektronike të komunikatës për shtyp mbi rezultatet e deklaramit të pasurisë të zyrtarëve të lartë për këtë vit. Komunikata për shtyp e datës 29 prill 2008 ka pasur shumë jehonë si në median e shkruar dhe atë vizive në paraqitjen e gjendjes së saktë mbi deklaramet e kryera nga zyrtarët e lartë nëpër institucionet qendrore.

Gjithashtu, Zyra për Marrëdhënie me Publikun në çdo moment ka qenë e gatshme për t'iu përgjigjur në mënyre profesionale kërkesave të ndryshme që vijnë nga gazetarë media, shoqëria civile apo dhe individë të thjeshtë mbi iniciativat ose detyrat e Agjensionit.

iii. Monitorimi i mediave gjatë periudhës janar - qershor 2008

Në këtë tabelë paraqiten numrat e shkrimeve/ose emisioneve të lajmeve apo emisioneve të veçanta të realizuara nga media të ndryshme mbi rastet korruptive prej muajit janar deri në qershor 2008.

	Media të cilat kanë raportuar rastet korruptive	Nr. i shkrimeve
Janar	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e	25

	re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	
Shkurt	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	18
Mars	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	21
Prill	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	11
Maj	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	6
Qershor	Gazetat: Koha Ditore, Infopress, Express, Epoka e re, Zëri, Kosova Sot, Bota sot, Iliria Post, Lajm, Televizionet: RTK, KTV, RTV21	15
Gjithsej		96

Gjithsej nga 96 shkrimet artikujt e botuar në mediat e shkruara dhe ato elektronike për 6 muajt e parë të këtij viti, kryesisht fokusimi ka qene rreth keqpërdorimeve në tenderët dhe auditimet që janë bërë nëpër institucionet komunale dhe ato qendrore. Artikujt e tjerë janë përqendruar në keqpërdorimet, keqmenaxhimin dhe neglizhencën në institucionet si KEK, Aeroport , PTK , Gjykata , Prokurori etj .

Ndërkaq lista e mëposhtme paraqet në mënyre të detajuar dhe kronologjike shkrimet në median e shkruar në lidhje me aktivitetet e Agjensionit dhe/ose shkrimet investigative për çështje qe kanë lidhje me fenomenin e korrupsionit.

Janar 2008

- 25 shkrime kryesisht për raste korruptive ku gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike;
- Raportet e auditimit kane qenë çështjet ku gazetarët janë fokusuar e kanë shkruar më shumë. Po ashtu është shkruar e bërë akuza për aferat korruptive në KEK dhe nëpër ministri;
- Gazetarët kanë shkruar shpesh gjatë muajit janar për projekte fantazëm të Ministrisë së Bujqësisë, ku dyshohet për keqpërdorime po ashtu edhe për komunat e Republikës së Kosovës ku janë gjetur parregullsi të mëdha.

Shkurt 2008

- 18 shkrime për raste korruptive nga institucionet publik, kritikohet Prokuroria e Kosovës se i mbyll rastet për korrupsion, flitet për individë të ndryshëm nga AKM-ja e deri te ndërmarrjet publike .
- Shumica e këtyre shkrimeve kanë të bëjnë me dyshimet për korrupsion në AKM, po ashtu edhe me keqpërdorime në tenderët e komunave.

- Gjatë këtij muaji është shkruar edhe korrupsionin në gjykata dhe prokurori dhe heshtja e tyre para këtyre dukurive;
- Shkrimet e tjera kanë të bëjnë me afëra korruptive nëpër spitale dhe PTK.

Mars 2008

- 21 shkrime të cilat kanë paraqitur ekskluzivisht Agjensionin dhe punën e kryer prej tij;
- Është trajtuar çështja e deklarimeve të pasurive dhe nëse do të përfundojë si duhet apo jo;
- Në muajin mars është shkruar për arrestimin e Drejtorit të Aeroportit dhe zyrtares së prokurimit, dhe pronarit të Petrol kompanisë;
- Po ashtu kanë qenë të botuar edhe artikuj për keqpërdorimet në KEK;
- Për Korporatën Energjetike të Kosovës është shkruar për çdo muaj për keqpërdorime.

Prill 2008

- 11 shkrime për Agjensionin dhe veprimtarinë e tij;
- Pas komunikatës nga Agjensioni për deklarimin e pasurisë, shkrimet kanë qenë të fokusuara rreth deklarimit të pasurive dhe mosdeklarimit të pasurive të ministrave dhe të gjithë zyrtarëve në detyra publike;
- Shkrimet kanë qenë kryesisht kritike ndaj qeveritarëve të cilët nuk e kanë bërë deklarimin e pasurisë së tyre.

Maj 2008

- Gjithsej 6 artikuj në gazeta;
- Shumica e shkrimeve kanë qenë shkrime për keqpërdorime në PTK dhe KEK

Qershor 2008

- Gjatë këtij muaji kanë qenë 15 shkrime;
- Shkrimet kanë trajtuar hetimet kundër gjykatësve dhe prokurorëve që janë burgosur për ryshfet, rasti i gjykatësve dhe prokurorëve të suspenduar muajt e fundit;
- Mediat i kanë kushtuar shumë vëmendje gjykatave dhe prokurorëve për mos kryerjen e punës së tyre në raste të ndryshme.
- Gjithashtu artikujt e botuar kanë të bëjnë me keqpërdorimet në Ministrinë e Tregtisë në kohën e Ministrit Bujar Dugolli.
- Dukuri tjera korruptive që janë trajtuar kanë qenë manipulimi me prona korrupsioni në shëndetësi.

iv. Aktivitete dhe bashkëpunimi

Gjatë muajit mars 2008, Agjensioni organizoi një fushatë ndërgjegjësuë e cila kishte si synim shërbyesit civil. Fushata kishte dy moto kryesore “ Korrupsioni mbaron këtu me ndihmën tuaj” dhe “Unë nuk jam i/e korruptuar”. Kjo fushatë u financua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë dhe Zyra e UNDP-së në Kosovë. Fushata u zbatua në kuadrin e një projekti të përbashkët për ndërgjegjësimin e publikut mbi punën e Agjencionit dhe nxitjen e tij për të bashkëpunuar me Agjensionin në zbulimin dhe parandalimin e rasteve

korruptive, në vijim të dy fushatave të mëparshme të zhvilluara e para në dhjetor 2006 dhe e dyta në shtator 2007. Fushata për shërbyesit publik u organizua në të gjitha ministritë në nivel qendror dhe në 15 komuna në nivel lokal.

Fushata ishte e konceptuar në mënyrë bashkëbisedimi me zyrtarët publik të këtyre institucioneve, në lidhje me informimin e përgjithshëm mbi rolin e AKK-së, kompetencat, mënyrën e bashkëpunimit, mënyrën e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit si dhe është bërë shpërndarja e materialeve të fushatës, shoqëruar me një broshurë me informacion të detajuar për punën e Agjensionit.

Impakti i përgjithshëm i fushatës i marrë nga shërbyesit civil ishte i mirë dhe shumë inkurajues, përveç njohurisë mbi punën e Agjensionit dhe mënyrën si ta kontaktojnë atë, shërbyesit civil patën mundësinë të shkëmbejnë mendime e të japin sugjerime se si mund të përmirësohet e fuqizohet puna për parandalimin e korrupsionit në sektorin publik dhe sidomos në ato sektorë që janë më të prekur e ku ka keqpërdorim të parashë publike.

Gjithashtu duhet përmendur fakti se brenda këtyre 6 muajve zyrtarë të Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit kanë marrë pjesë në mbi 20 debate në mediat elektronike, televizion dhe radio .

VII. PROBLEMET E NDESHURA

Për të funksionuar normalisht, AKK-ja është munduar të tejkalojë shumicën e problemeve me të cilat është ndeshur, megjithatë gjatë kësaj periudhe raportuese problemet e mëposhtme janë evidentuar si të pa tejkaluara:

Paqartësitë rreth ligjeve të aplikueshme: Kuvendi i Kosovës ka aprovuar dy ligje për plotësimin e kuadrit ligjor anti-korrupsion, përkatësisht Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nëntor 2007) dhe Ligjin për keklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik (Maj 2008). Megjithëse dihet rëndësia e këtyre ligjeve në funksionalizimin e Agjensionit, e ndërsa këto ligje janë të aprovuara, për shkaqe administrative Agjensioni ende nuk ka informata për zbatueshmërinë e tyre.

Pagat e vogla të zyrtarëve të Agjensionit: niveli i pagave është shumë i ulët e aspak motivues jo vetëm për zyrtarët të cilët janë tashmë në Agjension e kryejnë një punë me rrezikshëmri të lartë por edhe për pranimin e zyrtarëve të rinj ku për një vend pune konkurrojnë afro 50 kandidatë që nga CV-të e tyre shihet qartë se shumica nuk kanë përvojë por vetëm konkurrojnë me tendencën që të gjejnë punë.

Mungesa e trajnimeve profesionale: tashmë ka ardhur momenti që pas një viti e gjysëm funksionimi e ngritje kapacitetesh, zyrtarët që gjenden aktualisht në Agjension të kenë mundësinë të marrin pjesë në trajnime specifike e të specializuara e jo thjesht bazike e të përsëritura, në mënyrë që të rritet integriteti e efekshmëria në punë.

Mosbashkëpunimi i treguar nga institucionet për përpilimin e Strategjisë kundër Korrupsionit: procesi i përpilimi të strategjisë së re megjithë përpjekjet e pandalshme të Agjensionit për ta

pasur procesin sa më gjithëpërfshirës e transparent ka pasur si përgjigje një pjesëmarrje të ulët si nga institucionet publike të ftuara ashtu dhe nga sektori privat e shoqëria civile.

Pengesa në kryerjen në kohë të iniciativave ligjore: kjo çështje ka të bëjë me pengesat dhe zvarritjen në kalimin e miratimit e ndryshimeve të bëra në Ligjin kundër Korrupsionit, iniciativë ligjore e ndërmarrë nga Agjensioni, projektligj i cili ndodhet për momentin në Qeveri.

Mosgatishmëri për bashkëpunim nga institucionet mbi hetimet e kryera nga Agjensioni: pengesa të mëdha janë hasur kur Agjensioni ka kërkuar bashkëpunim për ofrimin e dokumentacionit relevant për hetimin, gjë që ka vështirësuar punën e Agjencionit e ka rrezikuar rezultatet e hetimeve.

Koordinimi jo i mirë me institucionet që kanë për mision luftën kundër korrupsionit: kjo sidomos në fushën e bashkërendimit të përpjekjeve dhe të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve më qëllim arritjen e rezultateve sa më të mira e dhënies së imazhin që si vullneti i mire që ekziston dhe aktivitete të ndryshme po ndërmerren.

Probleme me infrastrukturën: objekti në të cilin ndodhet aktualisht Agjensioni duke qenë se është ndërtuar me planimetrinë e nje objekti privat është shumë i papërshtatshëm për funksionim të mirëfilltë zyrash, sikundër tani me rekrutimin e zyrtarëve të rinj po shihet gjithmonë e më shumë se mungon hapësira adekuate për një funksionim normal.

Kompensimi material për anëtarët e Këshillit: ky kompensim nuk është i përcaktuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, kurse zyrat e ndryshme të Qeverisë nuk veprojnë sipas Urdhresës Administrative që rregullon këtë fushë.

VIII. PLANET DHE SFIDAT PËR GJASHTË MUJORIN E DYTË TË VITIT 2008

Për realizimin sa më të suksesshëm të misionit të Agjencionit si dhe për të arritur shumë objektiva afatshkurtër e afatgjata, Agjensioni parashikon se disa nga planet e sfidat me të cilat do të përballet në muajt në vijim:

- Të intensifikohet puna në realizimin e misionit të Agjencionit si dhe të realizohen përpjekjet për plotësimin e miratimit e kuadrit ligjor përkatës;
- Të kryhet në kohë dhe përmes një procesi gjithëpërfshirës e transparent përpilimi i Strategjisë kombëtare kundër korrupsionit si dhe të bëhen të gjitha përpjekjet që strategjia e re të kalohet nga qeveria e miratohet në Kuvend përpara fundit të vitit 2008;
- Në zbatim të Strategjisë së re kundër Korrupsionit, të kryhet nga Agjensioni deri në fund të vitit, procesi i udhëheqjes dhe koordinimit për përpilimin sa më të mirë të Planit të Veprimeve kundër Korrupsionit 2009-2011;
- Seleksionimi mbi baza përgatitore dhe profesionale i zyrtarëve të rinj që do të punësohen për të mbushur vendet vakante në Agjension;

- Kryerja e trajnimeve për ngritjen profesionale dhe të kapaciteteve të zyrtarët e rinj si dhe trajnime specifike e të specializuara me qëllim përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese;
- Takime me qytetarë, shërbyes civil, nxënës, studentë, mjekë dhe kategoritë të tjera profesionale me qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në drejtim të parandalimit e luftimit të korrupsionit.

IX. PËRFUNDIME

Lufta kundër korrupsionit është njëra nga sfidat më të mëdha për shtetin e Kosovës. Agjencioni Kosovar kundër-Korrupsionit është duke punuar fuqimisht që të sigurojë një hapësirë të qëndrueshme ku sundon rendi dhe ligji dhe ku harmonizohen përpjekjet dhe iniciativat e të gjitha mekanizmave institucioneve publike për të luftuar këtë fenomen. Por është shumë me rëndësi që përpjekjet e tona për një shoqëri ku sundon ligji dhe rendi, ku ka liri dhe transparencë të respektohen dhe të përkrahen nga të gjithë.

